Breaking News: DVP Gjirokastër/Finalizohet operacioni i koduar "Autenticitet"

06/02/2026

Raporti I Ngjarjeve, 6 Shkurt 2026

DVKM Vlorë

Fshehu në automjet, produkte ushqimore dhe mallra për të cilat paguhet akcizë, me qëllim kontrabandimin nga Shqipëria, procedohet penalisht 44-vjeçari.

Sekuestrohen mallrat dhe automjeti.

Gjatë kontrolleve të kryera në hyrje/dalje, në bazë të analizës së riskut, ndaj shtetasve dhe mjeteve me të cilat ata lëvizin, me qëllim parandalimin dhe goditjen e paligjshmërive në kufi, shërbimet e Policisë Kufitare të portit të Vlorës konstatuan në dalje të Republikës së Shqipërisë, një rast të tentativës për të kontrabanduar mallra.

Në lidhje me rastin u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin K. R., 44 vjeç, banues në Vlorë.

Gjatë kontrollit në automjetin që drejtonte, u gjetën të fshehura, produkte ushqimore dhe mallra për të cilat paguhet akcizë (duhan dhe cigare).

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Vlorës, për veprime të mëtejshme.

Tiranë/informacion paraprak

Në rrugën e Arbërit, kamioni me drejtues shtetasin Xh. H., është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin A. D.. Si pasojë janë dëmtuar 2 drejtuesit e automjeteve dhe 1 pasagjer, të cilët janë në kujdesin e mjekëve, jashtë rezikut për jetën.

Grupi hetimor punon për sqarimin e rrethanave të aksidentit.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Fier vunë në pranga shtetasin A. D., 63 vjeç, banues në Fier, pasi Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur që ky shtetas të kryejë në Shqipëri, pjesë e mbetur nga dënimi ë vjet e 8 muaj burgim, që i ka caktuar Gjykata e Milanos, për veprat penale "Njësetmarrja në organizatë kriminale" dhe "Trafikimi i lëndëve narkotike".

Gjithashtu, këta specialistë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin A. P., 34 vjeç, banues në fshatin Libofshë, Fier, pasi shërbimet e Policisë i gjetën një sasi të vogël lëndë të dyshuar narkotike kanabis.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor të DVP Fier arrestuan shtetasin A. H., 39 vjeç, banues në Tiranë, pasi duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur, ka humbur kontrollin dhe si pasojë automjeti është përplasur me barrierat e rrugës. Nga aksidenti është dëmtuar lehtë 39-vjeçari.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomike të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin F. S., 42 vjeç, banues në Fier, pasi në servisin e tij u gjetën automjete pa dokumentacionin përkatës, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-A. S., 51 vjeç, banues në Cakran, pasi ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së vëllait të tij;
-L. D., 39 vjeç, D. O., 19 vjeç dhe për një 17-vjeçar (babai dhe dy djemtë), pasi kanë ushtruar dhunë ndaj shtetasves L. M., 43 vjeçe (motra e shtetasit L. O.) dhe vajzës së saj të mitur;
-M. T., 28 vjeç, banues në fshatin Ferras, Fier, pasi ka ushtruar dhunë ndaj vëllait të tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lushnjë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. Gj., 37 vjeç, pasi u konstatua duke kryer punime pa leje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës

Specialistët për qarkullimin rrugor referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për:
-2 të mitur që u kapën duke drejtuar motorsipetë;
-shtetasin P. O., 74 vjeç banues në Durrës, pasi me automjetin që drejtonte në gjendje të dehur, në rrugën "Adria", ka përplasur 2 automjete të parkuara. Si pasojë, pati vetëm dëme materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit:

-A. M., 26 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale "Përvetësimi i titullit apo i detyrës shtetërore", pasi është paraqitur në Komisariatin e Policisë Durrës, ku është prezantuar si punonjës i një agjencie ligjdhatuese, për të marrë informacion meth disa të shoqërisë;

-R. H., 26 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet se ka vjedhur disa produkte, në një market në lagjen nr. 17;

-A. L. dhe E. C., të dy banues në Durrës, për veprat penale "Ndërtimi i paligjshëm" dhe "Pushtimi i tokës".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kavajë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit:

-N. P., 60 vjeç, banues në Kavajë, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij.

-H. D., banuese në Kavajë, pasi dyshohet për motive të dobëta, ka goditur me send të fortë, një të moshuar.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Shijak referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin L. Sh., 36 vjeç, banues në Shijak, pasi mbante në banesë, pa leje, 2 armë sportive, dylbi dhe tytë, të cilat u sekuestruan me cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Shërbimet e Sektorit të Qarkullimit Rrugor arrestuan në flagrancë shtetasit:
-P. C., 20 vjeç, banues në Korçë, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi;
-A. P., 44 vjeç, banues në Tiranë, pasi në qytetin e Bilisht, nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë, për të ndaluar automjetin që e drejtonte në gjendje të dehur.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare referuan materialet në Prokurori dhe shpalosi në kërkim shtetasin E. S., 35 vjeç, banues në Durrës, pasi dyshohet se i ka marrë një shumë parash, shtetasit D. S., duke e mashtruar se do t'i siguronte punësim në Slloveni.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Korçë referuan materiale shtesë në Prokurori, për shtetasin A. A., 43 vjeç, banues në fshatin Kamenicë, Korçë, pasi në muajin gusht 2025, dyshohet se i ka marrë shtetasit A. T., një shumë parash, duke e mashtruar se do t'i shiste një automjet. Punohet për kapjen e 43-vjeçarit, i cili është shpallur në kërkim më datë 02.02.2026, për të njëjtën vepër penale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Pogradec referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin N. T., 26 vjeç, banues në Pogradec, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në lokalin në përdorim të tij, rezultoi se ushtronte aktivitetin pa e paregistruar në organet kompetente. Gjithashtu, gjatë kontrollit të celularit të tij, u gjetën faqe për baste sportive. Celulari u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të informacionit të dhënë dje, për procedimin e një 15-vjeçari që kishte thyer me gur, xhamin e ditares së banesës së shtetasit G. H., në lagjen nr.5, Pogradec, bëjmë më dije se u referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për një 13-vjeçar (djali i shtetasit G. H.) pasi dyshohet se ka postuar në rrjete sociale, video me përmbajtje kërcënuese mbi këtë ngjarje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Maliq referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin G. M., 31 vjeç, banues në fshatin Sheqeras, Maliq, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëjetueses së tij.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

DVP Durrës/Finalizohet operacioni i koduar "Ndjekja", për kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim.

Lokalizohet dhe kapen 3 të kërkuar:
✅2 prej tyre të dënuar për prodhim/shitje narkotikësh ose transportim emigrantësh;
✅njëri, i akuzuar për vjedhje.

Si rezultat i kontrolleve dhe punës operative, të kryera me qëllim lokalizimin dhe kapjen e shtetasve të kërkuar për vepra penale të ndryshme, specialistët e Seksionit për Mbështetjen Operacionale të Hetimit lokalizuan, kapën në kuadër të operacionit "Ndjekja", dhe vunë në pranga shtetasit:

-Abdyl Kaçaça, 35 vjeç, banues në Durrës, të cilin Gjykata e Apelit, në vitin 2024, e ka dënuar me 5 vjet e gjysmë burgim, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Prej dënimit, atij i kanë mbetur për të vuajtur 2 vjet e 9 muaj burgim;

-J. M., 27 vjeç, banues në Durrës, të cilit i kanë mbetur për të vuajtur 3 vjet e 4 muaj burgim, nga dënimi i dhënë në vitin 2024, nga Gjykata e Elbasanit, për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve";

-V. T., 45 vjeç, pasi Gjykata e Durrësit i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Vjedhja".

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve:
-arrestuan shtetasin M. A., 31 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" i gjetën një sasi lëndë të dyshuar narkotike Kokainë, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale;
-arrestuan shtetasin A. H., 38 vjeç, pasi gjatë kontrolleve, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1 i gjetën sasi të lëndeve të dyshuar narkotike Kokainë dhe Cannabis, të cilët u sekuestruan me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 arrestuan shtetasit K. Xh., 48 vjeç dhe E. H., 35 vjeç, pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë vjedhur në 2 subjekte.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 arrestuan shtetasin J. Gj., 39 vjeç, pasi u kap duke vjedhur një biçikletë, ndërkohë që ishte me masë sigurie "Arrest në shtëpi".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për:
-shtetasin A. K, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur shtetasen A. K.;
-4 shtetasë të mitur, pasi janë konfliktuar me njëri-tjetrin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 arrestuan shtetasin D. A.(D), 29 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij, si dhe i ka dëmtuar derën e banesës.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5:
-arrestuan shtetasin E. U., 28 vjeç, pasi dyshohet se ka vjedhur çantën e një shtetasi, në një market;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin R. O., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6:
-arrestuan shtetasin G. M., 55 vjeç, si dhe referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen N. M. (bashkëshortë), pasi kanë goditur me grushte, për shkak të detyrës, shtetasin A. K., oficer sigurie në një shkollë;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për një shtetas të mitur pasi ka goditur me grushte një shtetas të mitur;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit M. S. dhe A. S., pasi kanë kanosur një shtetase, për motive pronësie.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin M. Gj., pasi në fshatin Bërxullë, është konstatuar duke hedhur dhera, për të ndryshuar destinacioninin e tokës, në tejkalim të lejes së dhënë.

Specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan shtetasit:
-E. B., 40 vjeç, pasi dje, në Bathore, ka aksidentuar shtetasen Sh. Sh., 61 vjeçe, këmbësore, e cila si pasojë humbi jetën;
-A. Xh., 35 vjeç, pasi duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur, ka përplasur 2 automjete, me pasojë dëme materiale;
-G. D., 57 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur.

Më datë 05.02.2026, kaliëzuan shtetasit:
-A. M., se është larguar nga banesa, vajza e tij, shtetasja S. M., 25 vjeçe. Punohet për gjetjen e saj;
-F. H., se janë vjedhur bateri në kompaninë ku ai punon, në Krujë. Punohet për identifikimin e kapjen e autorit/ve dhe dokumentimin e rastit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

DVKM Kukës

Qafë Morinë/Policia Kufitare godet 2 raste të tentativës për të kontrabanduar naftë nga Kosova.
Procedohen penalisht 2 shtetas.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të DVKM Kukës referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi për veprën penale "Kontrabanda me mallra për të cilët paguhet akcizë", për shtetasit:

-A. D., 25 vjeç, banues në Tropojë dhe I. P., 30 vjeç, banues në Pukë.

Në SPK Qafë Morinë, në hyrje të RSh-së, shërbimet e Policisë Kufitare, gjatë kontrollit në kamionin që drejtonte 30-vjeçari dhe në automjetin që drejtonte 25-vjeçari, gjetën dhe sekuestruan sasi nafte të padeklaruara në autoritetet doganore.

Sasia e naftës u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

DVP Gjirokastër/Finalizohet si rezultat i një hetimi disamujor, operacioni i koduar "Autenticitet". Goditen 3 raste të përdorimit të dokumenteve false.

✅Kishte siguruar certifikata false, për 16 kamionët në subjektin e tij, që me to të kryente transport ndërkombëtar mallrash, arrestohet 51-vjeçari.

✅Në pranga dhe 2 shtetas që posedonin 4 dokumente shkollore false.

Sekuestrohen 20 dokumentet.

Si rezultat i një hetimi të kryer me metoda proaktive, në koordinim me Prokurorinë e Gjirokastrës, për dokumentimin e veprimtarisë kriminale të disa shtetasve të përfshirë në falsifikim të dokumenteve, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare finalizuan operacionin e koduar "Autenticitet", gjatë të cilit u arrestuan shtetasit A. G., 51 vjeç, banues në Gjirokastër, V. V., 45 vjeç, banues në fshatin Nepravishtë dhe E. P, 38 vjeç, banues në Saranda.

Nga hetimet dyshohet se shtetasi A. G., administrator i një subjekti për transport ndërkombëtar mallrash (që të tretë shtetasit janë punësuar prej tij), i ka siguruar certifikata false, me to kamionët e subjektit të tij, duke i bërë ata me dokumente false, kryenin transport ndërkombëtar mallrash, duke shfrytëzuar mungesën e kontrollit ndërkombëtar.

Ndërkohë, shtetasit V. V. dhe E. P. i kishin bërë ata dokumente shkollore false, si diplomat e shkollës "Gjirokastër", diplomat e universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, librezat e notave, dokumente identifikimi, si dhe dokumente pagesash, duke i shitur ato, me çmime nga 1.000 deri 2.000 euro, ndërkohë janë ofruar edhe shërbime ndërmjetësimi, duke i ndihmuar shtetasit e tjerë, me anë dokumentesh, si dëshmitarë, ose me anë dokumentesh, si dëshmitarë, ose me anë dokumentesh, si dëshmitarë, ose